

UDHËZIM
Nr.2/1, datë 3.3.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 10.10.2007 “PËR MODELET E
LICENCE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe të udhëzimit nr.2, datë 18.1.2008 “Mbi një ndryshim në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licence, autorizimeve dhe certifikatave, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

1. Në pikën 4 të udhëzimit nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licence, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, modeli nr.113, ndryshohet dhe shtohet modeli 114 si më poshtë vijon:

Modeli	Emërtimi	Ngjyra	Stema/simboli	Shenja të tjera
1.LICENCA				
114	Licencë për kompetencë profesionale në fushën e transportit dhe sigurisë rrugore	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka

2. Modeli i ndryshuar nr.113 dhe modeli nr.114 janë bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E LIQENCIMIT

LIQENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

**KONSULENCË TEKNIKO – EKONOMIKE NË VEPRIMTARITË
E TRANSPORTIT RRUGOR**

I LËSHOHET:

Personit Fizik/Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Fushat e konsulencës:

.....
.....
.....
.....

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo liçencë i jep të drejtën mbajtësit të saj të ushtrijë veprimtarinë e konsulencës tekniko - ekonomike në një ose disa nga fushat e mëposhtme:
 - a) Drejtimin e veprimtarive të sipërmarrjeve dhe agjencive të transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra;
 - b) Ekspertizë në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e transportit rrugor.
 - c) Përcaktimin e kërkesave tekniko-ekonomike në blerjen e makinerive dhe pajisjeve për sektorë të ndryshëm të transportit.
 - d) Ekspertizë për llogaritjen e kostove operacionale dhe optimeve ekonomike në operacionet e transportit të brendshëm dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave.
 - e) Këshillimin, asistencën në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për operim në transport.
2. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
3. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
 - nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
4. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - Subjekti nuk plotëson më kushtet e kërkuara si, reputacion i mirë, kompetence profesionale dhe gjendje të përshtatshme financiare.
 - Provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të sakte dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E LIÇENCIMIT

LIÇENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

KOMPETENCË PROFESIONALE NË FUSHËN E
TRANSPORTIT DHE SIGURISË RRUGORE

I LËSHOHET:

Personit Fizik:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Diplomuar më:

Titulli:

Fushat e kompetencës:

a. Ekspert në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit të mjeteve në rrugë.

b. Ekspert autoteknik dhe vlerësues i dëmeve që shkakton mjete rrugor gjatë aksidentit në rrugë.

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo liçencë i jep të drejtën mbajtësit të saj të ushtrijë veprimtarinë e kompetencës profesionale në fushat e mëposhtme:
 - a) Ekspert në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit të mjeteve në rrugë.
 - b) Ekspert autoteknik dhe vlerësues i dëmeve që shkakton mjeti rrugor gjatë aksidentit në rrugë.
2. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një person tjetër.
3. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - emri i personit dhe adresa;
 - nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
4. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - nuk plotëson më kushtin e reputacionit të mirë sipas pikës 1 të nenit 8 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007.
 - ka paraqitur informacion jo të sakte dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.